



A.nr.572/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.572/2026, të datës 26.05.2026, të parashtruar nga ankuesi M.H, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Mergim Himaj me seli në Prishtinë, kundër organit të punësimit: Agjencia për Menaxhimin Emergjent në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 07.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.572/2026, të datës 26.05.2026, të parashtruar nga ankuesi M.H.

II. Pala ankuese udhëzohet në kontest juridiko-civil në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore.

A r s y e t i m

Ankuesi M.H, (*me tej referuar vetëm ankuesi*), me datë 26.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos përfitimit të pagës së trembëdhjetë (13) sipas Vendimit të Qeverisë me numër 02/07, të datës 30.03.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë ***nuk është kompetent*** për të vendosur lidhur me ankesën, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga provat e lëndës rrjedhë se:

- Ankuesi ka qenë i punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe së i njëjti sipas Akt të Emërimit me numër Ref:AME-QOER-Prishtinë 04/2013 të datës 31.01.2013, ka ushtruar pozitën *Koordinator i Qendrës Operative Emergjente Rajonale në Prishtinë*.

- Më vendimin 223/2025, të datës 26.12.2025, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent (tutje AME), ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës për arsye të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt nga data 02.01.2026.
- Me datë 07.04.2026, ankuesi ka parashtruar kërkesë tek AMNE për kompensim të pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2025.

II. Pretendimet Ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se nuk i është bërë kompensimi i pagës së trembëdhjetë (13) për vitin 2025, duke shtuar se ky mos kompensim është në kundërshtim me Ligjin Nr.10/L-100 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025 dhe Vendimin e Qeverisë me numër 02/07, të datë 30.03.2026. Kërkon që të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe te obligohet AME-ja që ankuesit ti kompensoj pagën e 13-të për vitin 2025, me kamatë ligjore prej 8%., nga data 01.04.2026, në afat prej 15 ditësh.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të kompetencës materiale të KPMSHCK-ës për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 02.01.2026 kishte statusin e nëpunësit civil, rrjedhimisht nga kjo datë ankuesi ka humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të fuqisë së ligjit (*ex lege*) pasi që ankuesi ka arritur moshën e pensionimit. Andaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet së Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë se ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk ka statusin e nëpunësit aktiv civil dhe në fakt meqenëse e drejta materiale e pretenduar në ankesë ka lindur pasi ankuesi është pensionuar, atëherë, Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses A.nr.572/2026.

Referuar konstatimet si më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji në kuptim të informimit të palës ankuese udhëzon palën ankuese që të drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore. Gjegjësisht, lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.572/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Mergim Himaj;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.